L I G J
Nr.8079, datë 29.2.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7788, DATË 9.2.1994 DHE NR.7899, DATË 2.2.1995

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993, në nenin 7 në pjesën "Për taksat nacionale" shkronjat "C" dhe "GJ" ndryshohen si më poshtë:

"C". Taksa për qarkullimin rrugor caktohet në masën 16% mbi çmimin e shitjes me pakicë të benzinës dhe gazoilit.

"GJ". Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti caktohet:

1. Për dëshmitë e grupit A.....2000 lekë
2. Për dëshmitë e grupit B.....3000 lekë
3. Për dëshmitë e grupit C.....3000 lekë
4. Për dëshmitë e grupit D.....2000 lekë
5. Për dëshmitë e grupit E.....2000 lekë
6. Për dëshmitë e grupit F.....3000 lekë

Në qoftë se dëshmia e grupit C merret nga grupi B taksa për pajisjen me dëshmi për drejtim automjeti do të jetë 1000 lekë".

Neni 2

Në nenin 8 pas fjalisë "Taksat arkëtohen nga organi që kryen shërbimin, të shtohen fjalët "dhe derdhen 100 për qind në buxhet" dhe fjala "ju lihet" të zëvendësohet me fjalën "ju jepet".

Neni 3

Lidhja nr. 2 dhe nr. 4 ndryshojnë sipas pasqyrave bashkëngjitur.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1415, datë 20.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

LIDHJA NR. 2
TAKSAT PËR SHËRBIMET KONSULLORE

Në lekë

1. Për lëshimin e pasaportave për dalje jashtë shtetit…….400
2. Për leje

kalimi……100

3. Për vizë të huajve në bazë të marrëveshjeve ose në bazë të reciprocitetit.-
4. Për shtetasit e shteteve ndaj të cilëve nuk kërkohet vizë hyrje merret taksë hyrjeje në territorin e Republikës së Shqipërisë në masën 5 dollarë amerikanë. Shtetasit e atyre shteteve që nuk marrin taksë vize për shtetasit shqiptarë janë të përjashtuar nga pagimi i taksës së hyrjes.-
5. Për lëshimin e pasaportave nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullatat…….3000
6. Për leje kalimi të lëshuara nga përfaqësitë diplomatike……2000
7. Për lëshimin e certifikatave të çdo lloji, për legalizimin e tyre ose të çdo dokumenti tjetër nga përfaqësitë diplomatike apo nga përfaqësitë konsullore:
a) për shtetasit shqiptarë jashtë shtetit.....3000
b) për shtetasit shqiptarë në bazë të reciprocitetit.....
8. Për zgjatjen e afatit të pasaportave nga përfaqësitë diplomatike apo nga konsullatat……..
1000
9. Për vërtetim certifikatash ose të dokumenteve të tjera të lëshuara nga autoritetet tona për të huaj ose të lëshuaranga autoritet e huaja, zbatohet parimi i reciprocitetit.-
10. Për vërtetim certifikatash ose dokumenteve të lëshuara nga autoritetet shqiptare për shtetasit shqiptarë……100
11. Përkthim dokumentesh nga përfaqësitë tona diplomatike……1000
12. Për verifikimin e dokumenteve nga përfaqësitë tona diplomatike……500
13. Për akte noteriale, prokura testamente etj., dhënë nga përfaqësitë tona diplomatike……..2000

LIDHJA NR.4
TAKSA PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA GJYQËSORE, NOTERIA DHE ZYRAT E HIPOTEKAVE DHE TË GJENDJES CIVILE

	Taksë fikse (në lekë)	Taksë proporcionale (ose progresive) (në përqindje)
A. Taksa për veprime juridike që kryhen nga administrata gjyqësore		
1. Për regjistrimin e personave juridik privatë (shtetas shqiptarë)……500		
2. Për regjistrimin e personave juridik privatë (shtetas të huaj)……3000		
3. Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit …….50		
4. Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të intersuarit…….50		
5. Për lëshimin e dëshmisë së penalitetit nga zyrat e gjendjes gjyqsore…….50		
6. Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Drejtësisë……..50		
7. Kërkesë padi që paraqiten në gjykatë		
- Për pension ushqimor-		
- Për vërtetim fakti……500		
- Padi për zgjidhje martese……1000		
- Padi për pevlefshmëri të veprimeve juridike…….1000		
- padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontra-		

ktore si dhe për shkaktim dëmi
me vleftë deri 100 000 lekë……1000
me vleftë mbi 100 000 lekë……1
- padi për kthim në punë…….-
- padi për pjestim pasurie…….1000
B. Taksë për veprime që kryhen nga përmbaruesi
gjyqësor.
1. Për vënien në ekzekutiv të vendimeve e titujve të
tjerë ekzekutivë me objekt të pavleftësueshëm……500
2. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve
të tjerë ekzekutivë me objekt të vleftësueshëm
- kundrejt shtetasve…….3
- kundrejt personave juridikë……..7
3. Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të
përmbaruesit gjyqësor……50

4. Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor
të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar
nga të intresuarit……..50
5. Për vënien në ekzekutim të vendimeve me
objekt pension ushqimor-
C. Veprime që kryhen nga zyrtat noteriale
1. Përpilimi i testamenteve…….300
2. Kontrata për kalim pronësie……..500
3. Prokurë (redaktim)
- të përgjithshme……..100
- të posaçme……100
4. Akte noteriale të ndryshme (redaktim)…….100
5. Kopjim dhe vërtetim njësia me origjinalin……100
6. Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësia me
origjinalin…….50
7. Vërtetim firme në banesa ose spitale…….50
8. Veprime të tjera noteriale……..50
D. Taksat e veprimet që kryhen në zyrat e hipotekave:
1. Për regjistrimin e vendimit i cili përmban
fitimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e
paluajtshme që deklaron të pavlefshme
veprimet juridike për kalimin e pronësisë
së regjistruarmë parë…….200
2. Për regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë
në lidhje me fitimin me anë të trashëgimisë
të pronësisë mbi sende të posaçme…….200
3. Për regjistrimin e vënies së sekuestros
mbi sendet e paluajtshme…….100
4. Për heqjen e hipotekës…….100
5. Për lëshimin e çdo dëshmie të interesuarve
nga zyrat e ipotekës……..100
E. Taksa e akteve dhe e pullës
1. Për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile…….20
2. Për lëshimin e pasaportave për brenda vendit……..50
3. Për regjistrimin përfundimtar të vendbanimit të ri…20
4. Për marrjen e çdo akti të omeluar ose të zhdukur të
gjendjes civile si dhe për korigjimet e tyre……..20
5. Për regjistrimin e dhënies së shtetësisë……500

6. Për regjistrimin e lënies së shtetësisë
   për çdo person madhor…….500
7. Për regjistrimin e vendimit të ndërrimit
   të emrit ose mbiemrit…….500
8. Për çdo lidhje martese……..400